



KALLËZIM PENAL

KALLËZUES: Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Albana Vokshi Deputete e Partisë Demokratike, me adresë komunikimi: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 11, Tiranë dhe adresë e-mail: pd@rithemelimi.com

OBJEKTI: Kallëzim i veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga Neni 248 i Kodit Penal, “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” parashikuar nga Neni 328 i Kodit Penal, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, parashikuar nga Neni 328/a i Kodit Penal, si dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, parashikuar nga Neni 329 i K.Penal, kryer në bashkëpunim (Neni 25 i K.Penal).

KUNDËR:

- Dallëndyshe BICI, me detyrë Drejtoreshë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) ;
- Punonjësit e ASHK Tiranë, të përfshirë në këto abuzime, të cilët do të rezultojnë nga hetimi se kanë konsumuar veprat penale ;
- Drejtori i ASHK Dega Elbasan ;
- Punonjësit e ASHK Dega Elbasan, të përfshirë në këto abuzime, të cilët do të rezultojnë nga hetimi se kanë konsumuar veprat penale; si dhe
- Çdo person tjetër i paidentifikuar ende, por që do të rezultojë me përgjegjësi penale nga ky hetim.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Nenet 75/a 274, 280 dhe 283 e vijues të Kodit të Procedures Penale, Nenet 25, 248, 328, 328/a, dhe 329 i Kodit Penal.

DREJTUAR: PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT – SPAK.

Të nderuar Prokurorë të SPAK,

I nderuar z. Dumani, Drejtues i SPAK,

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju paraqesim kallëzimin ndaj Drejtoreshës së Përgjithshme të ASHK Dallëndyshe Bici, si dhe personave të tjerë të përfshirë, për veprat penale të sipërcituara, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore penale të cënuara, si dhe analizën juridike dhe indiciet e faktet me anë të të cilave vërtetohet konsumimi i veprave penale.

RRETHANAT E FAKTIT:

I nderuar Z. Prokuror,

Unë kallëzuesi, pasi ditën e shtunë 13.05.2023, ditë heshtjeje zgjedhore, kam rënë në dijeni të disa veprimtarive penale të parashikuar nga nenet 248, 328 dhe 329 të Kodit Penal dhe më konkretisht, “Shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, nga Drejtoresha e ASHK Dallëndyshe Bici, paraqesim kallëzimin kundër shtetasve të sipërcituar, për ndjekje nga organi i Prokurorisë, pasi në gjykimin tonë ka dyshime të arsyeshme se këta shtetas mund të kenë konsumuar elementët e veprave penale të sipërpërmendura.

Me veprimet e tyre, në shpërdorim të detyrës, dyshohet se po tentojnë të joshin qytetarë të caktuar si dhe/ose kanë bërë presion ndaj qytetarëve të caktuar 1-ditë para zgjedhjeve, në heshtje zgjedhore, duke u shpërndarë atyre legalizimin apo certifikatat e pronësisë së banesave, me qëllimin e vetëm për të shtrembëruar vullnetin e tyre në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14-Majit 2023.

Nga pamjet e filmuara drejtëpërdrejtë nga mediat televizive, rezultoi se Agjensia shtetërore e kadastrës (ASHK) në Tiranë, është përfshirë në një skandal vetëm një ditë përpara zgjedhjeve të 14-Majit 2023. Kjo agjensi e drejtuar nga Dallëndyshe Bici, po shpërndan legalizime për qytetarët në këmbim të votës. Nga pamjet filmike por edhe nga intervistat që gazetarët arritën t’u marrën qytetarëve të cilët hynin e dilnin nga

godina e ASHK nga dera kryesore, por një pjesë e tyre hynte dhe në mënyrë të fshehtë nga garazhi i ASHK.

Një nga qytetarët në Tiranë është shprehur se ka ardhur për legalizimin pasi janë thirrur me telefon nga zyrtarët e institucionit. ASHK dihet botërisht se nuk është thuar asnjehere në ditë të zakonshme e hapur për qytetarët, sepse ka kohe që ajo i ka dixhitalizuar procedurat dhe aplikimet. Qytetarët vuajnë prej kohësh mungesën e transparencës nga ky institucion. *Por çfarë ndodh 1-ditë para zgjedhjeve?* ASHK në mënyrë të koordinuar vendos të nxjerrë punonjësit e saj të administratës në punë, në një ditë jo vetëm pushimi zyrtar, por edhe më e rëndësishmja, në një ditë që është ditë heshtje zgjedhore, në mënyrë që të korruptojë dhe blejë votën e atyre qytetarëve me lejet e legalizimit.

Edhe në Elbasan rezultoi se ASHK ishte e hapur ditën e shtunë 13.05.2023 dhe qytetarë të ndryshëm u panë dhe u filmuan që hynin në institucionin publik ditën e shtunë dhe dilnin prej aty me shkresa në duar. Qytetarët për mikrofonin e TV të ndryshme nuk preferonin të sqaronin se çfarë kryenin aty ditën e shtunë, 1-ditë para zgjedhjeve. Burime të sigurta tregojnë se qytetarë të caktuar, pasi kontaktohen me telefon, sms ose mjete të tjera, shkojnë 1 ditë para zgjedhjeve për të terhequr lejen e legalizimit / certifikatën e pronësive të banesave të tyre. Kuptohet që ky favor kaq i madh nuk jepet pa kundërshtim nga institucioni dhe punonjësit e tij. Dihet se në datën 14-maj janë zgjedhjet dhe qytetarët që pranojnë të marrin certifikatën e pronësive nga dera e pasme e institucionit të ASHK ditën e shtunë, e dinë fare mirë se si dhe për ke duhet të votojnë në zgjedhjet vendore në qytetet e tyre respektive.

Këto nuk janë raste të izoluar, por raportimet në kohe reale tregojnë se ky fenomen i blerjes së mbështetjes dhe votave për kandidatet e qeverisë, me anë të legalizimeve, në gjykimin tonë duhet të ketë me dhjetëra raste të përpjekjeve të administratës publike që me drejtoret dhe me punonjësit e saj, tentojnë në të gjithë vendin, të cilët edhe ditën e heshtjes zgjedhore, të përdorin zyrtarët e Shtetit që të joshin, ose të kërcënojnë me legalizimin e banesave të tyre qytetarë, në mënyrë që ato të mos shprehin vullnetin e tyre të lirë në 14-maj 2023.

Nisur edhe nga fakti se dencocimeve tona të shumta dhe apeleve publike për këto raste, asnjë nga institucionet ligjzabuese akoma nuk kanë vepruar, e gjejmë të domosdoshëm paraqitjen e këtij kallëzimi penal me qëllim që organi i prokurorisë të nisë hetimet e thelluara lidhur me këto raste.

LIGJI I APLIKUESHËM:

Neni 75/a i K.Pr. Penale

Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

“Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:

a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;

b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës”.

Neni 280 i K.Pr. Penale

Marrja dijani për veprën penale

“Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët”.

Neni 283 i K.Pr. Penale

Kallëzimi nga ana e shtetasve

“1. Çdo person që ka marrë dijani për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policies gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.

3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre”.

Neni 248 i Kodit Penal

Shpërdorimi i detyrës

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

Neni 328

Korrupsioni aktiv në zgjedhje

“Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t’u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet”.

Neni 328/a

Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore

“Pjesëmarrja e një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore në shërbimin civil ose në një funksion jopolitik në administratën shtetërore, në kundërshtim me ligjin, në aktivitetet ose fushatën zgjedhore, të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Detyrimi ose organizimi për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor i nxënësve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Detyrimi ose kërkesa drejtuar shtetasve, nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, që kundër vullnetit të tyre ose nën kërcënimin e përdorimit të masave administrative ose disiplinore, për të marrë pjesë jo një parti politike ose një kandidat në zgjedhje, ose për të votuar në një mënyrë caktuar, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.

Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet”.

Neni 329 i Kodit Penal

Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje

“Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të veprimtarisë së tij në administrimin zgjedhor dënohet me burgim nga një vit deri në katër vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet”.

ANALIZA LIGJORE:

Nga indiciet, provat dhe faktet e paraqitura, ka vend për dyshime të arsyeshme se shtetasit e kallëzuar të kenë konsumuar veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, vepra penale të parashikuara nga nenet 25, 328, 328/a dhe 329 të Kodit Penal.

Veprat penale rezultojnë se janë konsumuar me veprime aktive, nëpërmjet nga njëra anë joshjes me ane të shpërndarjes së legalizimit të banesave dhe/ose certifikatave të pronësisë së qytetareve, ndërsa nga ana tjetër me anë të presioneve dhe kërcënimeve ndaj qytetarëve pikërisht me procesin e legalizimit dhe ligjshmërinë e dokumenteve të pronësisë së qytetareve, çdo gjë e kryer me veprime dhe mos-veprime në funksionin të marrjes së përfitimeve elektorale gjatë zgjedhjeve bashkiake.

Në bashkëpunim me njëri-tjetrin, shtetasit e kallëzuar si aktivistë dhe/ose patronazhistë të Partisë Socialiste, pavarësisht se mbajnë poste të larta zyrtare si Drejtoresha e ASHK, apo drejtoret rajonale të ASHK në Tiranë, Elbasan apo qytete të tjera, me veprimet e tyre kanë konsumuar veprën penale “Shpërdorimit të detyrës”, “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, si dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” me qëllim deformimin e vullnetit të atyre qytetareve në votimin për zgjedhjet lokale të 14 Majit 2023 në Tiranë, Elbasan por edhe në qytetet e tjera ku ky fenomen i shëmtuar po kryhet sot në datë 13.05.2023, në ditën e heshtjes zgjedhore.

Nisur nga ky rast konkret, nxisim organin e prokurorisë që duke marrë shkas nga këto raste, të thellojë hetimet e saj edhe për raste të ngjashme të cilat tentojnë në thelb të deformatojnë vullnetin dhe votën e zgjedhësve Shqiptarë në zgjedhjet vendore të 14-Majit 2023.

KONKLuzion:

I nderuar Z. Dumani,

Nga sa analizuam më sipër, rezultojnë përfundimisht se nga drejtuesit dhe punonjësit e institucionit të ASHK në nivel qendror e vendor, janë ezauruar të gjitha elementet e veprave penale të kallëzuara.

Për pasojë, me anë të këtij kallëzimi që ju paraqesim, marrim përsipër të bëhemi përçues të zërit të atyre qytetarëve të ndershëm të këtij vendi të cilët besojnë se ligji është një dhe i barabartë për të gjithë.

Përfundimisht nga ana e SPAK, kërkojmë:

Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj shtetasve të kallëzuar, si dhe personave të tjerë të identifikuar apo jo nga ky kallëzim, si dhe kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme për marrjen në pyetje e të gjithë personave të përmendur në kallëzim, për sqarimin më të saktë e më të plotë të rrethanave të parashtruara më sipër.

KALLËZUES:

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga

Deputete

Albana Vokshi



Provat:

1. Shkrim dhe Video nga Syri.TV: “**Skandal, kadastra shpërndan legalizime për qëllime elektorale një ditë përpara votimeve**” – 13.05.2023. **LINK:**

<https://www.syri.net/politike/592284/skandal-kadastra-shperndan-legalizime-per-qellime-elektorale-nje-dite-perpara-votimeve/>

2. Videot bashkëngjitur që tregojnë çfarë ka ndodhur ne ambientet e ASHK.

KRIMI- (https://www.syri.net/politike/592293/gjykata-e-vlores-vendos-arrest-me-burg-per-fredj-belerin-dosja-i-kalon-ne-spak/) ELEKTORAL%2F)

Edi Rama erdhi në pushtet duke premtuar legalizime falas për banesat e qytetarëve. Por pas 10 vitesh në pushtet dhe vetëm 5 ditë para zgjedhjeve lokale të 14 majit, qeveria socialiste po i përdor sërish legalizimet për të mashtruar qytetarët e për t'u marrë votën.

Zyrtarë të Kadastrës kanë shkuar dje në zonën e Laknasit në Bashkinë e Kamzës, ku kanë kontaktuar qytetarët, duke u premtuar se do u legalizojnë banesat, proces të cilin e kanë zvarritur prej shumë vitesh. Kanë qenë vetë qytetarët që kanë filmuar këtë krim elektoral dhe e kanë denoncuar pranë Syri Televizion, ku duket zyrtarët e Kadastrës teksa shkojnë derë më derë dhe u kërkojnë emrat banorëve që nuk kanë legalizuar banesat, duke u premtuar legalizimin e tyre.

Qytetari denoncohet: Çfarë jeni duke bërë?

Zyrtari i Kadastrës: Legalizimet.

Zyrtari i Kadastrës-banores: Edhe emrin pak të lutem?

Qytetari denoncohet: Pse legalizimet?

Zyrtari i Kadastrës: Ule pak atë (telefonin).

Qytetari denoncohet: Nuk e ul se ju jeni duke bërë një gjë të paligjshme!

Pak javë më parë, kryeministri Edi Rama largoi nga pozicioni i drejtorit të Kadastrës, Artan Lamën, e në vend të tij emëroi Dallëndyeshe Bicin, një prej të besuarave të Ramës, që është kallëzuar penalisht jo pak herë për zbatimin e urdhrave politike e për kryerjen e ndërhyrjeve të paligjshme në dëm të biznesmenëve dhe qytetarëve. Por këtë herë duket se misioni i radhës është përdorja e Kadastrës për efekt elektoral, ku punonjësit e Kadastrës keqpërdoren për të shkuar derë më derë për të premtuar legalizime, një mashtrim që qytetarëve u është bërë për disa vite me radhë. Tashmë u takon organeve të drejtësisë, që të hetojnë rastin dhe krimet elektorale të zyrtarëve të Kadastrës.

© SYRI.net

(https://www.syri.net/politike/592264/fotolajm-gazetarja-vellaj-po-mashtron-hapur-edhe-me-piramiden/?utm_source=projectagora&utm_medium=contentdiscovery)

Reagimi - FOTOLAJM/ Gazetarja: Vellaj po mashtron hapur edhe me Piramidën

Para pak ditësh, gazetarja Beti Njuma publikoi një foto nga larta të Piramidës së Tiranës. Pamjet u bënë virale, jo vetëm për shkak se punimet tregojnë se ajo është ...

Syri | Lajmi i fundit

(https://www.syri.net/politike/592264/fotolajm-gazetarja-vellaj-po-mashtron-hapur-edhe-me-piramiden/?utm_source=projectagora&utm_medium=contentdiscovery)

(https://likkofy-shop.com/al-power-zoom-pp/)

Syze vetërregulluese? Quket Power Zoom

| Sponsored (https://popup.taboola.com/sq/?template=colorbox&utm_source=syri.net&utm_medium=referral&utm_cor

(https://likkofy-shop.com/al-power-zoom-pp/)

(https://bloginabcd.com/prelanding-myku/index-white.html)

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored (https://popup.taboola.com/sq/?template=colorbox&utm_source=syri.net&utm_medium=referral&utm

(https://trc.taboola.com/syri.net/og/3/click?pi=%2Fpolitike%2F591274%2Fsyri-tv-legalizime-per-vota-denoncohet-me-pamje-krimi-elektoral/ (https://bloginabcd.com/prelanding-myku/index-white.html)

(https://bloginabcd.com/prelanding-dhimbjet/index-white-2.html)

Ja disa këshilla në lidhje me dhimbjen e kockave

Blog | Sponsored (https://popup.taboola.com/sq/?template=colorbox&utm_source=syri.net&utm_medium=referral&utm

(https://trc.taboola.com/syri.net/og/3/click?pi=%2Fpolitike%2F591274%2Fsyri-tv-legalizime-per-vota-denoncohet-me-pamje-krimi-elektoral/ (https://bloginabcd.com/prelanding-dhimbjet/index-white-2.html)

(https://bloginabcd.com/prelanding-dhimbjet/index-white-2.html)

VIDEO/ Hysni Sharra, kandidati i opozitës për Vlorën, intervistë në 'Kafe Shqeto'

(https://www.syri.net/politike/591467/video-hysni-sharra-kandidati-i-opozites-per-vloren-interviste-ne-kafe-shqeto/)

'Edi Rama, ju garantoj unë, i ka të numëruara kohërat'

(https://www.syri.net/politike/591468/edi-rama-ju-garantoj-une-i-ka-te-numeruara-koherat/)

VIDEO-LAJM/ Fabrika e asfaltit elektoral në Krrabë vazhdon punën, edhe pasi u denoncua

(https://www.syri.net/politike/591472/video-lajm-fabrika-e-asfaltit-elektoral-ne-krrabe-vazhdon-punen-edhe-pasi-u-denoncua/)

Pronat, raporti: Qeveria iu detyrohet 857 milionë euro ish-pronarëve! Kompensimi financiar mjaft i ngadaltë

(https://www.syri.net/politike/591475/pronat-raporti-qeveria-iu-detyrohet-857-milione-euro-ish-pronareve-kompensimi-financiar-mjaft-i-ngadalte/)

Zgjedhjet e 14 majit, Igli Cara takon banorët e Durrësit: Dëshira dhe energjia pozitive për ndryshimin ndihet kudo

(https://www.syri.net/politike/591476/zgjedhjet-e-14-majit-igli-cara-takon-banoret-e-durresit-deshira-dhe-energja-pozitive-per-ndryshimin-ndihet-kudo/)

 DENONCO (HTTPS://WA.ME/+355697009691)